URDHËR
Nr. 360, datë 1.4.2026

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera në qarkun Dibër.
2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes;
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes;
4. Forcimin e masave të biosigurisë;
5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privatë dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit veterinar në fermat që mbarshtojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 18.10.2025, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për Sëmundjen e Murtajës së Ruminantëve të Vegjël (PPR)".
9. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	RRETHI	NJËSIA ADMINISTRATIVE	FSHATI
		3 km	
1.	Bulqizë	Gjoricë	Gjoricë e Epërme
2.	Bulqizë	Gjoricë	Gjoricë e Poshtme
3.	Bulqizë	Shupenzë	Okshatinë
4.	Bulqizë	Shupenzë	Shupenzë
5.	Bulqizë	Shupenzë	Homesh
6.	Bulqizë	Shupenzë	Boçevë
7.	Bulqizë	Shupenzë	Vlashaj
8.	Bulqizë	Shupenzë	Topojan
9.	Bulqizë	Shupenzë	Kovashicë
10.	Dibër	Maqellarë	Podgorcë
		10 km	
11.	Bulqizë	Shupenzë	Gjuras
12.	Dibër	Maqellare	Majtare
13.	Bulqizë	Zerqan	Peladhi
14.	Bulqizë	Zerqan	Gotvi
15.	Bulqizë	Zerqan	Sofraçan

16.	Bulqizë	Zerqan	Tërbaç
17.	Bulqizë	Zerqan	Strikçan
18.	Dibër	Maqellarë	Çernenë
19.	Dibër	Maqellarë	Bllatë e Sipërme
20.	Dibër	Maqellarë	Kërçisht
21.	Dibër	Maqellarë	Dovlan
22.	Dibër	Maqellarë	Erebare
23.	Dibër	Maqellarë	Herbel
24.	Dibër	Maqellarë	Burim
25.	Dibër	Maqellarë	Dovolan

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla